



UNIVERSITETI I TIRANËS
R E K T O R I
Projekti "ERASMUS+"

Nr. 3973/11 Prot.

Tiranë, më 06/03/2017

FTESË PËR OFERTË
Nr. 3 / 1, Datë 06.03.2017

PËR
"BLERJE PAJISJE ELEKTRONIKE HARDWARE"
me fond limit = **28,000 euro pa tvsh**

DREJTUAR: TË GJITHË OPERATORËVE EKONOMIK TË INTERESUAR PËR TË MARRË PJESË

Publikuar në website-n e Universitetit të Tiranës

Rektorati i Universitetit të Tiranës, në zbatim të Marrëveshjes së Komisionit Europian me qeverinë Shqiptare me ligjin nr. 9840, datë 10.12.2007 në kuadër të IPA-s, të Partnership Agreement ndërmjet Koordinatorit Lider të Nish-it, Serbi "Universit u Nisu" (UNI) me "Universitetin e Tiranës", për Projektin "Enhancement of HE Research Potential Contributing to Further Growth of the WB Region/Fuqizimi i potencialit kërkimor në Institucionet e Arsimit të Lartë duke kontribuar në zhvillimin e Rajonit të Ballkanit Perëndimor" (Re@WBC) me numer Ref: 2015-3133 / 561586 - EPP-2015-RS-EPPKA2-CBHE-JP; Ligjit nr.44, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative në RSh", si dhe mbështetur në kërkesat e UT-së me nr.prot.2476/1 datë 01.09.2016 dhe Universitetit Ismail Qemali, Vlorë me nr.prot.2476/2 datë 15.09.2016, Ju fton të paraqisni ofertën tuaj me objekt "Blerje pajisje elektronike hardware" sipas preventivit të mëposhtëm dhe specifikimeve teknike bashkëlidhur:

Nr	Emertimi i mallit (specifikimet teknike minimale attached)	Njesia matese	Sasia (shifra)	Sasia (shkrim)
1	Notebook 13.3"	copë	14	katëmbëdhjetë
2	Kompjuter PC all-in-one desktop	copë	10	dhjetë
3	Printer laser	copë	6	gjashtë
4	Printer all-in-one	copë	6	gjashtë
5	Printer laser color	copë	8	tetë

Data e zhvillimit të tenderit do të jetë **15.03.2017, deri në ora 11:00am**, në adresën Rektorati i UT-së, kati 2, Protokolli, dorëzuar me zarfa të mbyllur.

Kriteret dhe kushtet e ofertës/Terms and conditions of the offer:

Operatorët ekonomik **duhet të dorëzojë në një zarf të mbyllur pranë autoritetit kontraktor me protokoll, jo me vonë se data dhe ora e caktuar**, plotësimin e dokumentave si më poshtë, (dhe sipas shtojcave bashkëlidhur):

1. Formularin e Ofertës.
2. Deklaratë për specifikimet teknike dhe shpërndarjen e sasisë sipas kërkesës së AK duke marrë përsipër transportin deri në destinacion (Universitetin e Tiranës dhe Universitetin Ismail Qemali, Vlorë).
3. Ekstraktin mbi historikun e subjektit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, i cili duhet të përfshijë objektin ose ekuivalentin e objektit të prokurimit (lëshuar jo me pare se 3 muaj nga data e zhvillimit).
4. Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare per tre vitet e fundit 2013, 2014, 2015 me vlere jo më pak se 3,500,000 lekë.
5. Furnizime të ngjashme, vërtetuar nëpërmjet Faturave tatimore të shitjes me subjektet private ose vertetime realizim kontratash me subjektet publike, ku totali i tyre të jetë me vlerë jo më të vogël se 30% i fondit limit.
6. Operatori ekonomik duhet të paraqecë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë EN ISO 9001-2008 në fushën e objektit që prokurohet.

Kriteri i vlerësimit:

- Cmimi me i ulet i ofertës së përgjegjshme.
- Ku nevojiten jo më pak se 3 oferta të vlefshme nga 3 operatorë të ndryshëm.
- Dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Afati i realizimit të furnizimit do të jetë brenda **30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.**

Formulari i kontratës është bashkëlidhur. Kontratat me operatorin fitues do të lidhen nga insitucionet respektive.

**REKTORI
PROF.DR. MYNYR KONI**

**Në mungesë dhe me porosi
ZV/REKTORI
PROF. DR. SHEZAI RROKAJ**

SPECIFIKIME TEKNIKE DHE SASIA E SHPËRNDARJES MIDIS UNIVERSITETEVE

Reference: Project "Enhancement of HE Research Potential Contributing to Further Growth of the WB Region/Fuqizimi i potencialit kërkimor në Institucionet e Arsimit të Lartë duke kontribuar në zhvillimin e Rajonit të Ballkanit Perëndimor" (Re@WBC)
me numer: 2015-3133 / 561586 - EPP-2015-RS-EPPKA2-CBHE-JP;

Objekti: BLERJE PAJISJE ELEKTRONIKE HARDWARE

Nr	Emërtimi i mallit	Specifikime teknike minimale	Njësi	Sasia	
				Universiteti i Tiranës	Universiteti Ismail Qemali, Vlorë
1	Notebook	Notebook, Ekran LED 13.3", rezolucion (1440X900), Procesori Intel i5 dual core 1.4GHz; Memorje RAM 4GB me frekuence 1666 MHz LPDDR3, SSD HD128 GB, WiFi 802.11 a/b/g/n, Bluetooth 4.0, USB 3.0x2, Tastiere QWERTY. Garancia min.2 vjet, MacBook Air ose ekuivalent	copë	7	7
2	Kompjuter desktop all-in-one	Kompjuter/PC all-in-one desktop, Ekran LED 21.5" 1.8GHz AMD ose ekuivalent, Procesor A4-6210, Memorje RAM DDR3 4GB me frekuence 1666 MHz, Memorje HDD 500GB, full HD Led display, Built-in/perfshire DVD RW, USB 3.0, card reader 6-ne-1, kamera min.1.3 Mp 720p, përfshirë altoparant, Tastiere QWERTY. Garancia min.2 vjet, Sistemi i operimit Microsoft Windows 8.1;	copë	5	5
3	Printer laser	Printer laser, bardh e zi, per leter A4, min.600x600 dpi, 20 ppm. Garancia min.1 vit	copë	3	3
4	Printer all-in-one	Printer all-in-one, per leter A4, bardh e zi, per leter A4, min. 600x 600 dpi, 20 ppm, scanner A4 600 dpi. Garancia min.1 vit.	copë	3	3
5	Printer laser color	Printer laser color, per leter A4, min.600X600 dpi, 20 ppm. Garancia min.1 vit	copë	4	4

FORMULARI I OFERTËS

Emri i Ofertuesit : _____

Për: **Rektoratin e Universitetit te Tiranes**

projekti RE@WBC me nr.ref: 2015-3133 / 561586 - EPP-2015-RS-EPPKA2-CBHE-JP

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje pajisje elektronike hardware”**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është _____ **(vlera ne shifra dhe fjale) Euro pa TVSH;**
2. Çmimi total i ofertës sonë është _____ **(vlera ne shifra dhe fjale) Euro me TVSH.**

Nr.	Emertimi i mallit (përcaktoni markën e ofruar me specifikimet bashkëlidhur)	Njesi	Sasia	Çmimi (Euro)	Vlera (Euro)
1	Notebook 13.3”	copë	14		
2	Kompjuter PC all-in-one desktop	copë	10		
3	Printer laser	copë	6		
4	Printer all-in-one	copë	6		
5	Printer laser color	copë	8		
Shuma pa Tvsh					
TVSH (20%)					
Vlera Total					

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula

Shënim: Konvertimi në Lek do të bëhet me kursin e këmbimit të Komisionit European për muajin në të cilin oferton.

http://ec.europa.eu/budget/contracts_grants/info_contracts/infoeuro/index_en.cfm

DEKLARATË

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____.**2017** nga Autoriteti Kontraktor **Universiteti i Tiranës**, me objekt **“Blerje pajisje elektronike hardware”**, me fond limit 28,000 euro pa tvsh, për projektin **RE@WBC me numer Ref: 2015-3133 / 561586 - EPP-2015-RS-EPPKA2-CBHE-JP.**

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ , deklaroj se:

- Përbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.
- Shpërndarja e sasisë do të jetë sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, duke marrë përsipër transportin deri në destinacion (Universiteti i Tiranës dhe Universiteti Ismail Qemali, Vlorë).

Data e dorëzimit të deklaratës:

Përfaqësuesi i ofertuesit:

Nënshkrimi:

Vula:

FORMULARI I KONTRATËS
MARRËVESHJE/KONTRATË FURNIZIMI
OBJEKTI: “ _____ ”

Projekti “Erasmus +” (Re@WBC),
me nr. Ref: 2015-3133 / 561586 - EPP-2015-RS-EPPKA2-CBHE-JP,
(Fuqizimi i potencialit kërkimor në Institucionet e Arsimit të Lartë duke kontribuar në
zhvillimin e Rajonit të Ballkanit Perëndimor)

NENI 1

PALET

1. Autoriteti Kontraktues: UNIVERSITETI I TIRANËS/....., përfaqësuar nga Rektori, Z. Mynyr Koni.....
2. Kontraktuesi: “ _____ ” shpk, me administrator Z. _____, me nr. NIPT-i _____.

NENI 2

TERMAT E KËSAJ MARRËVESHJE:

1. Me “Autoritet Kontraktor” do të kuptohet Universiteti i Tiranës dhe Universiteti i Vlorës.
2. Me “Kontraktues” do të kuptohet pala që merr përsipër të kryejë furnizimin për Autoritetin Kontraktor.
3. Me “furnizim” do të kuptohet furnizimi me pajisje elektronike për Rektoratin e UT.
4. Me “Çmim” do të kuptohet shpërblimi që do të marrë i porositori duke përfshirë këtu të gjitha detyrimet fiskale në fuqi, sipas objektit bazuar në Urdhrin e Blerjes nr. __, datë _____, Ftesën për Ofertë nr. __, datë _____.

NENI 3

OBJEKTI

1. Objekti i kësaj marrëveshje është furnizimi me pajisje elektronike hardware, për Universitetin e Tiranës dhe Universitetin Ismail Qemali Vlorë, si më poshtë, me specifikime sipas aneksi nr.1:

Nr	Emertimi i mallit	Njesi	Sasi	Çmimi LEK pa tvsh	Vlera LEK pa tvsh	Çmimi € pa tvsh	Vlera € pa tvsh
1	Notebook	copë	14				
2	Kompjuter PC all-in-one desktop	copë	10				
3	Printer laser	copë	6				
4	Printer all-in-one	copë	6				
5	Printer laser color	copë	8				
	Çmimi pa TVSH						
	TVSH						
	Vlera me TVSH						

2. Nga ana e tij Kontraktuesi merr përsipër të ofrojë këtë furnizimin ndaj Autoritetit Kontraktor kundrejt një çmimi të caktuar duke i garantuar atij besnikëri dhe korrektësi në kryerjen e lëvrimit, sipas specifikimeve teknike te Aneksit nr. 1.

NENI 4

AFATI

1. Afati i kryerjes së furnizimit do të jetë brenda ___ ditëve nga nënshkrimi i marrëveshjes së furnizimit. Me pëlqimin e të dyja palëve kjo marrëveshje mund të zgjatet edhe tej këtij afati në mënyrë automatike.
2. Nëse palët do të mendojnë të zgjidhin marrëveshjen duhet të lajmërojnë njëra - tjetrën të paktën 2 ditë para.

NENI 5

ÇMIMI DHE MËNYRAT E PAGESËS

1. Furnizimi i përcaktuar në objektin e kësaj kontrate do të ketë një vlerë të përgjithshme prej _____ (_____) lekë me tvsh.
2. PAGESA do të kryhet në këtë mënyrë: Pas përfundimit të të gjitha detyrimeve që lindin nga kjo kontratë, shoqëruar me:
 - a. Faturën origjinale tatimore të shitjes së Furnizuesit, që tregon përshkrimin e mallrave, sasinë, çmimin për njësi dhe shumën totale;
 - b. Proces-verbalin e marrjes në dorëzim të mallit.
 - c. Çertifikatën e origjinës së mallrave dhe garancisë, e cila shoqëron faturën.
3. PAGESA do të kryhet në Bankën _____, në llogarinë bankare nr. _____, me IBAN _____, që Kontraktuesi ka vënë në dispozicion të AK.

NENI 6

SIGURIMI I KONTRATËS DHE GARANCIA

1. Kontraktuesi duhet të paraqesë Sigurimin e Kontrates në shumën prej (10% të çmimit të kontrates) për të siguruar egzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës. Sigurimi i Kontrates do t'i lëshohet ose kthehet, menjehere Kontraktuesit me përfundimin e plote të kontratës.
2. Garancia: Mallrat e ofruar duhet të mbulohen nga garancia jo më pak se 12 muaj nga data e lëvrimin tek AK, në varësi të specifikimeve teknike të Aneksit nr. 1.

NENI 7

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

1. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë korrektësi dhe përmbushje të detyrave brenda afateve të caktuar nga palët në këtë kontratë.
2. Autoriteti Kontraktor detyrohet të paguajë vlerën e furnizimit sipas kushteve të përcaktuara në nenin 5 të kësaj kontrate pa qënë nevoja e lajmërimit më përpara nga Porositësi.
3. Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë informacion të plotë mbi të gjitha detyrat që i kërkohen.
4. Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë vlerën e furnizimit të përcaktuar në nenin 5 të kësaj kontrate.
5. Kontraktuesi detyrohet të kryejë me besnikëri dhe korrektësi të gjitha detyrat e përcaktuara në nenin 3 të kësaj kontrate duke iu përmbajtur afateve të përcaktuara.
6. Në rast të kërimit të ndonjë furnizimi mbi atë të parashikuar në nenin 3 të kësaj kontrate palët mund të vendosin së bashku tarifa të tjera me pëlqimin e përbashkët.

NENI 8

RUAJTJA E SEKRETIT

1. Të dyja palët angazhohen në ruajtjen e sekretit profesional për probleme të cilat kanë lidhje me objektin e kësaj marrëveshje. Të dyja palët angazhohen të respektojnë njëri-tjetrin maksimalisht dhe të përmbushin detyrat e marra përsipër.

NENI 9

FORCAT MADHORE

1. Furnizuesi nuk do të jetë përgjegjes për penaltete ose ndërprerje kontrate për mos përmbushje të furnizimit në qoftë se kjo vonese në performancën ose mospërmbushje e detyrimeve sipas Kontratës vjen si rezultat i një ngjarje që është Forcë Madhore dhe deri në masën që ajo e shkakton mospërmbushjen.
2. Për qëllimet e kësaj klauzole, "Force Madhore" do të thotë një ngjarje përtej kontrollit të Furnizuesit dhe që nuk përfshin fajin e Furnizuesit apo neglizhencën dhe që është e paparashikueshme. Këto ngjarje mund të përfshihen por mund të mos kufizohen vetëm me një akt të AK ne kapacitetin e tij sovran, luftërat ose revolucionet, zjarret, përmbytjet, epidemitë, kufizimet e karantinës, dhe embargo te ngarkesës.
3. Në qofte se lind situata e një Force Madhore, Furnizuesi do të njoftojë menjëherë AK me shkrim për këto kushte dhe shkakun që e ka sjelle atë. Vetëm në qoftë se udhëzohet ndryshe nga AK me shkrim, Furnizuesi do të vazhdojë të kryejë detyrimet e tij sipas Kontratës për aq sa është praktike në mënyre të arsyeshme, dhe do të kërkoj të gjitha mjetet alternative të arsyeshme për performancën të pa penguara nga ngjarja e Forcës Madhore.

NENI 10

ZGJIDHJA E MARRËVESHJES

1. Marrëveshja përfundon me mbarimin e afatit të përcaktuar.
2. Marrëveshja mund të zgjidhet edhe para mbarimit të këtij afati me pëlqimin e të dyja palëve pasi të kenë ezauruar detyrimet reciproke.
3. Marrëveshja mund të zgjidhet nga secila palë duke lajmëruar të paktën 2 ditë para.
4. Marrëveshja mund të zgjidhet nga Autoriteti Kontraktor nëse Kontraktuesi nuk përmbush detyrimet e percaktuara ne nenin 1, nenin 3, nenin 4, nenin 6 dhe nenin 8.

NENI 11

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

1. Çdo interpretim i termave do të merret në favor të dyja palëve dhe në kuptimin e përdorshëm të tyre në standardet normale.
2. Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve do të zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Tiranë.

Kjo marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe, në 4 (katër) kopje.

UNIVERSITETI I

REKTORI

Mynyr KONI

.....

KONTRAKTUESI

“ _____ ” shpk

Administratori
